



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Nr. 229/11 Prot.

Tiranë, më 19/09/2016

V E N D I M

Nr.105, Datë 19/09/ 2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË TIRANË,
“MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË EKONOMIKE –
FINANCIARE DHE VLERËSUES”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko – financiare dhe vlerësues”, të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë, Tiranë, për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Nga auditimi për hartimin e PBA-ve dhe të projekt buxheteve vjetore, pas muajit gusht (faza e dytë), vërehet se në planifikimin përfundimtar të shpenzimeve për investime shumë produkte investimi, ishin planifikuar apo shtuar në shpenzimet buxhetore pa kaluar më parë nga ekipet e menaxhimit të programeve, ose nga Drejtoritë përkatëse që hartojnë kërkesa shtesë për investime, por shtesa e këtyre produkteve është bërë direkt me shkresën e apovimit të tavanëve nga Ministria e Financës, duke vënë në diskutim punën e ekipeve të menaxhimit të programeve apo të institucioneve të varësisë.

Gjithashtu konstatohen ndryshime gjatë gjithë vitit në vlera të larta në destinacionet e objekteve të planifikuara për investime nga buxheti, duke bërë që Projekt Buxhetet Afatmesme, të rezultojnë thujse formalisht (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 16-18, 20-23, 28-30 dhe 32-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Në mënyrë që të rritet efektiviteti i përdorimit të fondeve për investime, në planifikimin e tyre ekipet menaxhuese dhe strukturat drejtuese të ministrisë, të studiojnë e të konkludojnë që fondet e vëna në dispozicion të shkojnë për objekte të një rëndësie të veçantë dhe me fonde të plota ndërtimi apo rikonstruksioni, për të realizuar objektivat e çdo programi.

Strukturat drejtuese të ministrisë dhe ekipet e menaxhimit të programeve të mos lejojnë që për shtesat dhe ndryshimet në programimin e shpenzimeve për investime të kalojnë jashtë kërkesave ligjore, duke shkelur kështu kompetencat dhe marrëdhëniet institucionale.

Në vazhdimësi

2. Nga auditimi për planifikimin e zërave të shpenzimeve për “fondin e pagave” dhe “sigurimeve shoqërore”, konstatohet se për shërbimin spitalor i cili financohet nëpërmjet paketave të shërbimeve, llogaritja e tyre është bazuar në strukturën e miratuar dhe numrin aktual të punonjësve, si dhe të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, pa marrë në konsideratë produktet e këtyre shërbimeve, ku në disa spitale bashkiake treguesi i shfrytëzimit të shtratit është në nivele minimale, kjo për të kaluar në financimin e shërbimit sipas produkteve dhe kostimit të tij (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 16, 27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të marrin masat e nevojshme për një planifikim real të shpenzimeve në shërbimin spitalor, duke u mbështetur në treguesit e performancës së tij.

-Ministria e Shëndetësisë referuar treguesve të kostimit të këtij shërbimi dhe treguesve të performancës së tyre të shohë mundësinë e riorganizimit të tyre, duke kaluar në spitale ditore, pasi kjo do të bënte dhe financimin e këtyre shërbimeve në bazë të produkteve të tyre.

Në vazhdimësi

3. Nga auditimi konstatohet se nga aparati i këtij institucioni, i cili është pjesë e programit buxhetor “Planifikim, menaxhim, administrim” janë çelur fonde të konsiderueshme në shpenzimet për investime, të cilat u takojnë programeve të tjera buxhetore, kryesisht në fund të vitit, çka e vështirëson procesin e zbatimit të kontratave duke lënë shteg për moszbatim të dispozitave ligjore, pasi koha për likuidimin e shpenzimeve nga kjo njësi është shumë e limituar (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë të marrin masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla, të cilat ndryshojnë treguesit e buxhetit sipas programeve, por dhe janë burim për moszbatim të dispozitave ligjore për administrimin e aseteve.

Në vazhdimësi

4. Nga auditimi rezulton se, në pasqyrat përmbledhëse të Ministrisë së Shëndetësisë konsolidohen dhe treguesit e pasqyrave financiare të Qendrave Spitalore, por vetëm treguesit e Aktiveve të Qëndrueshme dhe të Fondeve, shpenzimet për investime dhe burimet e tyre, pasqyrën e amortizimit të AQT, pa përfshirë në të llogaritë e Klasës 4, si në Aktiv dhe në Pasiv dhe shpenzimet korente të këtyre njësive. Duhet vënë në dukje që shpenzimet korente të këtyre njësive që kanë kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shërbimin që ofrojnë, financohet nga buxheti nëpërmjet llogarisë buxhetore 604 “Transferta korente të brendshme”, por që nuk përfshihen në pasqyrat financiare të këtij të fundit.

Për kryerjen e këtyre veprimeve prej vitesh, pa asnjë mbështetje në Standardet e Kontabilitetit, në Ministrinë e Shëndetësisë nuk ka një manual apo udhëzim për mënyrën se si veprohet apo bazën ligjore në të cilën mbështeten, pasi kjo mënyrë e hartimit të evidencës

kontabile ka lënë jashtë vëmendjes së të dy institucioneve jo vetëm krijimin dhe ndjekjen e detyrimeve si debitore, por dhe kreditore në shërbimin spitalor (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të marrin masa që në të ardhmen të eliminohet një praktikë e tillë, duke konsoliduar në pasqyrat përmbledhëse të gjithë llogaritë, si të aktivitetit dhe të pasivit.

Në vazhdimësi

5. Nga auditimi i pasqyrave financiare përmbledhëse dhe anekseve që e shoqërojnë konstatohet se, të dhënat e formatit 3/1 “Shpenzime të ushtrimit”, për të dy vitet periudhë auditimi, për zërat e shpenzimeve kanë ndryshime të theksuara në krahasim me të dhënat e buxhetit, të cilat nuk justifikohen me regjistrimet në kontabilitet të shpenzimeve të konstatuara, nga shpenzimet e likuiduara në thesar. Sa më sipër tregon se nga hartuesit e pasqyrave financiare përmbledhëse veprimet janë bërë në mënyrë mekanike, vetëm mbledhje aritmetikore, pa bërë një analizë krahasimore me të dhënat e buxhetit (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 47, 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financës, në hartimin e pasqyrave financiare si, përmbledhëse, por dhe në pranimin e pasqyrave të njëjësive të varësisë, të bazohet në metodën krahasimore duke analizuar dhe treguesit e buxhetit.

Në vazhdimësi

6. Në relacionin e përmbledhjes së llogarive vjetore, ishin evidentuar detyrimet për secilën njësi varësie, duke bërë një ndarje të këtyre detyrimeve sa janë me shpresë arkëtimi apo likuidimi, sa janë krijuar mbi 10 vjet, sa nuk janë likuiduar apo arkëtuar për faj të strukturave që duhet të merren me to.

Konstatohet se në detyrimet debitore ka një rritje prej rreth 100 milion lekë, në krahasim me periudhën e mëparshme, kryesisht në debitorët e ndryshëm, si rezultat i pasqyrimit në këtë llogari të gjobave të vendosura gjatë inspektimeve të kryera, por të pa vjela nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 50, 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me njësitë e varësisë të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme arkëtimin e detyrimeve, si dhe të bëjë sistemimin e tyre mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Në vazhdimësi

7. Nga auditimi konstatohet se Ministria e Shëndetësisë, deri në përfundim të auditimit nuk ka krijuar një regjistër të asetëve në tërësi, si dhe regjistër të pronave të paluajtshme në veçanti për të gjithë sistemin dhe as regjistër të pronave të dhëna me qira, në pajtueshmëri me kërkesat e udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njëjësive në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III. “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, të marrë masat e nevojshme për hartimin e regjistrit të aktiveve me gjithë të dhënat, në zbatim të kërkesave të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njëjësive në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III.

Menjëherë

8. Nga auditimi i asetëve konstatohet se institucioni nuk ka kryer procesin e evidentimit dhe regjistrimit në ZRPP të AQT-ve jo vetëm në njësitë e varësisë, por dhe ato në administrim të aparatit të saj dhe pse procesi i regjistrimit të pronave është përcaktuar si një prioritet në PBA 2015-2015.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me regjistrimin e pasurive të paluajtshme të Aparatit të MSH Tiranë u konstatua se nuk është bërë regjistrimi i pasurisë së sipërfaqes së truallit të përgjithshëm dhe i ndërtesës së Ministrisë, nuk është aplikuar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe nuk është përgatitur dokumentacioni përkatës. Mangësitë në regjistrimin e pasurive të paluajtshme, mungesa e hartimit të dokumentacionit përkatës, vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Gjatë periudhës së auditimit ka dalë urdhri i Titullarit të ministrisë nr. 158, datë 15.04.2016 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë”, i cili u është dërguar njësitëve të varësisë së bashku me metodologjinë e punës për kryerjen e këtij procesi. Në këtë urdhër është përcaktuar afati i përgatitjes së materialit, që është muaji shtator 2016 (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 57, 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve bashkë me Drejtorinë e Financës, të marrë masa për të ndjekur procesin e përgatitjes së dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurisë së patundshme brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e ministrit.

Menjëherë

9. Nga auditimi i pasqyrave financiare të Aparatit konstatohet se në aktiv të saj pasqyrohet vlera e TVSH -së e objekteve të Qendrave Shëndetësore, të ndërtuara me kontributin e fondacionit “Gj H K” dhe fondacioni “M”, e cila në fund të vitit 2015 arrin vlerën 14,852,978 lekë, e konkretisht:

Viti	Emërtimi	Nr. QSH	Vlera
2012	TVSH për Qendrat Shëndetësore	7	2,364,693
2013	TVSH për Qendrat Shëndetësore	6	7,153,543
2014	TVSH për Qendrat Shëndetësore	21	3,333.121
2015	TVSH për Qendrat Shëndetësore	9	2,001,621
	TOTALI	43	14,852,978

Konstatohet se vlera e mësipërme mbahet në kontabilitetin e aparatit të ministrisë në zërin “Caktime”, megjithëse nga donatori dhe përfituesi janë hartuar akt dhurimet, në prezencë të palëve dhe të sipërmarrësit. Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe nuk kanë marrë në evidencën e tyre kontabël vlerat përkatëse të objekteve, duke mos pasqyruar saktë aktivet e këtyre njësitëve e duke sjellë njëkohësisht dhe pasaktësi në përllogaritjen e amortizimit, megjithëse nga ministria ka korrespondencë me njësitë përkatëse prej disa vitesh, sistemimi i TVSH përsëri, nuk është kryer (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, të ndjekë dhe përmbyllë procesin e transferimit të vlerës së TVSH-së në objektet përkatëse, si dhe të kërkojë regjistrimin e këtyre objekteve në ZRPP-të e rretheve përkatëse.

Menjëherë

10. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2015, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e varësisë kanë krijuar detyrime të reja në shumën 20,769 mijë lekë, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtimit”, të ndryshuar”, nga të cilat të regjistruara

në sistemin e thesarit janë 13,198 mijë lekë dhe të paregjistruara në shumën 7,571 mijë lekë. Nga të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave për krijimin dhe monitorimin e detyrimeve të reja, rezultojnë të raportuara **16.300 mijë lekë**, ose me një diferencë prej **4,469 mijë lekë**.

Detyrimet e reja të krijuara në vitet 2014-2015 përbëhen nga vendime gjyqësore për largimet me pa të drejtë nga puna të punonjësve të shëndetësisë, kryesisht në disa Drejtori të Shëndetit Publik në rrethe.

Ministria e Shëndetësisë me strukturat e saj të varësisë, nuk ka marrë masa për t'i apeluar në Gjykatën e Lartë për 23 vendime gjyqësore, që rëndojnë padrejtësisht shpenzimet e buxhetit të shtetit, si dhe vënien para përgjegjësisë të shkaktarëve (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financës, të rakordojë detyrimet me ministrinë e Financës, për të pasur një raportim real të tyre.

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të marrë masat e nevojshme për të apeluar në Gjykatën e Lartë 23 vendime gjyqësore, pasojat e të cilëve rëndojnë padrejtësisht shpenzimet e buxhetit të shtetit, si dhe të evidentojë dhe mbajë qëndrim ndaj personave përgjegjës.

Menjëherë

11. Konstatohet që me kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimeve për barnat dhe investimet, në KVO apo Njësitë e Prokurimit janë përfshirë punonjës të njësisë të varësisë, të cilët janë shpërblyer me nga dy paga, ndërkohë që kanë përfituar dhe pagën përkatëse në institucionet ku ata janë pjesë e strukturave përkatëse, gjithsej në shumën 277,837 lekë, ndërkohë që M SH, ka në strukturën e vet të përhershme Drejtorinë e Prokurimeve (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 54-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, të marrë masa që në të ardhmen të shmangen procedura të tilla, për të mos rënduar shpenzimet e institucionit.

Në vazhdimësi

12. Gjatë vitit 2014 Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar dy tenderë me objekt shërbim:

“*Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit S*” i zhvilluar në vitin 2014 me fond limit 190,841,022 lekë për dy vjet, me procedurë “I hapur”.

“*Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit P*” i zhvilluar në vitin 2014 me fond limit 161,707,824 lekë për dy vjet, me procedurë “I hapur”.

Nga auditimi lidhur me “*Rregullshmërinë, ligjshmërinë e llogaritjes së fondit limit*” u konstatua se llogaritja e tij, nuk është në përputhje me pikën 2 të Kreu-t të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” I ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 90-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Me zhvillimin e këtyre tenderëve, MSH duhet të rishikojë/negociojë me kompanitë kontraktore masën e përqindjes vjetore të mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve, nëse do të mundësohej ulja e kësaj përqindje për pajisjet të cilat kanë një vlerë të lartë financiare në bilancin e spitaleve dhe ato që janë të blera brenda një periudhe 3 vjeçare. Gjithashtu, M SH duhet të unifikojë vlerën fikse për pajisjet e së njëjtës natyrë (si skanerë etj, pavarësisht burimit të financimit për blerjen, me kredi apo me fonde drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit) dhe të të njëjtit prodhues, mbi të cilin do të aplikojë përqindjen e mirëmbajtjes. Ministria e

Shëndetësisë duhet të gjejë elementët e nevojshëm për përmirësimin e dokumentacionit në tërësi, ku përfshihet dhe DST, me qëllim krijimin/sigurimin e kushteve, për të nxitur pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë ofertues, në këtë procedurë prokurimi, e cila normalisht do të çonte në një ofertë më të leverdishme për autoritetin kontraktor. Në mbështetje të kësaj, M SH të hartojë/miratojë një manual të veçantë për mënyrën, formën dhe procedurat që duhet të ndjekin spitalet për raportimin periodik mujor që duhet të bëjnë pranë drejtorisë përkatëse në M SH, në lidhje me shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore.

Në vazhdimësi

13. Nga auditimi konstatohet se bashkëlidhur pagesave për blerjen e mallrave për çdo rast është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave nga komisioni i ngritur me urdhër të NA, por plotësimi i tij është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës pa një përshkrim të hollësishëm të mallrave të marra.

Për blerjen e kasave fiskale, është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim në Aparatin e ministrisë nga komisioni i ngritur me urdhër të Titullarit, por ky mall nuk është bërë hyrje në magazinë, nuk është pasqyruar në kontabilitetin e njësisë, si dhe nuk është pasqyruar si mall në ruajtje. Kjo pajisje edhe në momentin e auditimit është gjendje dhe e pa instaluar e vënë në punë, pasi ky institucion nuk kryen asnjë veprim me arkën në lekë. Po kështu dhe njësitë e varësisë nuk kanë konfirmuar hyrjen e mallit në magazinë.

Me urdhër shpenzimin nr. 514 deri 528, datë 24.12.2015, janë likuiduar OE, në shumën 21,064,964 lekë gjithsej, për hartimin e “Projekt preventiva-zbatimi për rikonstrukcionin e ambulancave dhe Qendrave Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, sipas kontratave të lidhura për 10 lote. Projekt preventivat janë marrë formalisht në dorëzim nga komisionet e ngritura nga DSHP në rrethe, ku në përbërje të tyre nuk ka specialist të fushës (inxhinier) e për rrjedhojë nuk është bërë një analizë e vlerës së preventivuar nga OE, për secilin objekt.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e M F nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pika 42 deri 50 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” dhe pika 52-60 “Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues” dhe Udhëzimin nr. 57, datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde të auditimit në prokurimet...” (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që menjëherë të bëjë hyrje kasën fiskale, ta paraqesë vlerën e saj në evidencën kontabile, si dhe të shohë mundësinë e instalimit të saj në njësitë e varësisë, meqenëse nuk kryen veprime me lekë në dorë. Njësitë e varësisë të konfirmojnë hyrjen e mallit në magazinë dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet.

Menjëherë

14. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për blerjen e medikamenteve për trajtim spitalor, konstatohet se nga 525 barna të ndara në lote, programuar për t'u blerë për vitin 2014, me fond limit 1,529,017,385 lekë, 51 prej tyre janë të pa regjistruar ose u ka mbaruar afati regjistrimit, të cilat firmat importuese apo shpërndarëse nuk i kanë regjistruar. Për caktimin e fondit limit, komisioni ka marrë për bazë çmimin Cif të deklaruar nga importuesi apo shpërndarësi sipas autorizimit të lëshuar nga prodhuesi. Kjo mënyrë nuk është efektive pasi për barnat e paregjistruara apo që u ka mbaruar afati i regjistrimit, lejohen vetëm me lejë importi nga Ministri dhe fondi limit përcaktohet vetëm mbi bazën e çmimit të deklaruar nga një ofertues, duke sjellë si pasojë që fondi limit të hartohet mbi bazën e deklaratës së një operatori ekonomik dhe jo nëpërmjet konkurrimit me çmimin e ofruar nga disa operatorë për të marrë për bazë çmimin më të ulët, në zbatim të VKM nr. 62, datë 01.12.2012 “Për mënyrën e funksionimit të komisionit të çmimit të barnave”, i ndryshuar, pika 4 ku është përcaktuar se:

“Mbajtësit e autorizimit të tregimit të barit ose përfaqësuesi i tyre i autorizuar, përfaqësitë farmaceutike të huaja në Shqipëri, brenda datës 30 shtator të çdo viti, deklarojnë me shkresë, në zarf të mbyllur, pranë Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, çmimet "CIF" euro ose dollarë, për barnat e importit, dhe çmimet "EXË" (ex-Works) në lekë, për barnat e fabrikuara në vend”, nga të cilat përzgjidhet çmimi më i ulët (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 81-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Barnave”, të ketë objektiv që, numri barnave të paregjistruara në procesin e programimit të nevojave për medikamente të jetë minimal ose i barabartë me kërkesën për barna të reja që hyjnë në treg, si dhe marrjen e masave për regjistrimin e tyre brenda vitit kalendarik, si një ndër kriteret orientues për programimin efektiv të fondit limit në procedurat e prokurimit publik.

Në vazhdimësi

15. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për “blerje medikamente etj” për trajtim spitalor, u konstatua përgjithësisht pjesëmarrje e ulët e operatorëve ekonomikë (rreth dy, por edhe në rastet kur janë evidentuar më shumë se një, operatorët e tjerë, kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar me mangësi, që ka çuar në skualifikimin e tyre. E veçanta është se po këta operatorë pjesëmarrës në tenderë të tjerë, e kanë paraqitur dokumentacionin të plotë e për më tepër janë shpallur fitues. E përbashkët në të dy rastet është se vlera e fitimit të tenderit është pothuaj e njëjtë me vlerën e fondit limit, çka të bën të dyshosh për ekzistencën e “marrëveshjeve të fshehta” midis operatorëve ekonomikë (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 81-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003”Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e bashkëpunimit me KLSH-në, të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës për marrjen e masave të nevojshme me qëllim sqarimin/shmangien e një shtate të tillë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Nga auditimi i kryer për programimin e nevojave për medikamente për trajtim spitalor, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, në asnjë rast nuk është shoqëruar me bilancin material të çdo qendre spitalore dhe në tërësi për Ministrinë e Shëndetësisë, ku të pasqyrohen gjendjet në fillim të çdo viti, nevojat për medikamente spitalore dhe kërkesa për furnizim gjatë vitit ushtrimor, me qëllim plotësimin maksimal të nevojave për medikamente që ka çdo qendër spitalore dhe sistemi shëndetësor në tërësi (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 81-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Autoriteti kontraktor në procesin e programimit të nevojave për vitin pasardhës, detyrimisht duhet të hartojë dhe të pranojë nga njësitë vartëse “Bilancin Material” ku të evidentohet gjendja e medikamenteve, e cila të konsiderohet dokument bazë me rëndësi të veçantë në sistemin shëndetësor, pasi nëpërmjet tij identifikohen medikamentet gjendje, të papërdorura apo që u afron data e skadencës, me qëllim njohjen e gjendjes dhe marrjen e masave për rishpërndarjen e medikamenteve për përdorim në spitale të tjera.

Në vazhdimësi

17. Gjatë auditimit u konstatuan raste të kualifikimit të OE dhe madje të shpallur fitues me oferta ekonomike më të larta nga ato OE të skualifikuar, të cilët janë paraqitur në konkurrim me oferta ekonomike më të ulta, natyrisht edhe këto pa i plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese të miratuar nga NJP (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 102-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Në të ardhmen AKQB, nëpërmjet KVO-ve, të merren të gjitha masat, që të gjejë zbatim edhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 4 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar, në lidhje me fituesin e tenderit, kur të gjithë konkurrentët paraqiten me ndonjë mos plotësim të kërkesës kualifikuese, duke parë të arsyeshme kur ka konkurrentët, që paraqiten vetëm me vlera të vogla, dhe që nuk cenon realizimin e projekteve dhe janë të gjitha mundësitë të korrigjohen në vazhdim të procedurës së prokurimit. Të ndërpritet shpallja e fituesve të tenderëve për OE, që nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese të miratuar nga NJP dhe që janë me oferta ekonomike më të larta, siç është vepruar deri tani në këtë njësi shpenzuese.

Në vazhdimësi

18. Në të gjitha tenderët e blerjeve të mallrave, materialeve mjekësore dhe barnave, KVO-të kanë konsideruar si realizim kërkesë të NJP, paraqitjen e katalogëve pa u përkthyer në gjuhën shqipe. Në këto katalogë janë cilësuar edhe paraqitja e specifikimeve teknike përkatëse si kërkesë kualifikuese e veçantë. Mos përkthimet e katalogëve nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe bien ndesh me DST të miratuar me rregullat e prokurimit publik si dhe me vetë praktikën e dokumenteve të përgatitura nga NJP, të miratuar nga TAK. Po kështu bie ndesh me VKM nr. 914, datë 20.12.2014, Seksioni I “Informacioni i përgjithshëm”, neni 12 “Njoftimi i kontratës”, si dhe neni 14 “udhëzime për ofertuesit/ kandidatët”, cilësojnë shumë qartë se në këtë dokument duhet përfshirë mes të tjerave gjuha ose gjuhët e ofertave dhe dokumenteve, e konkretisht: *“Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm përfshin:; gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;”*.

Cilësohet: *“...Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”*.

Gjithashtu u konstatuan shumë raste të pranimit të certifikatave të ndryshme të cilësisë si për mallra e materialet apo punët publike nga KVO-të, të cilat janë origjinale, ku një pjesë e certifikatës është në gjuhë të huaj dhe po aty një pjesë është edhe në gjuhën shqipe. Një veprim i tillë bie ndesh me legjislacionin në fuqi, pasi përkthimet njihen si të mirëqenë vetëm kur realizohen nga përkthyes me licencë dhe të vërtetuar nga noterët (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 102-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

AKQB të marrë të gjitha masat për të ardhmen, në respektim të legjislacionit të cituar më sipër dhe atyre të trajtuar hollësisht në projektraportin e auditimit të mos merren të mirëqenë katalogët, që nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe. AKQB duhet të gjejë format përkatëse brenda legjislacionit se si do të realizohet pranimi i këtyre katalogëve në gjuhën shqipe.

Gjithashtu të mos pranohet asnjë certifikatë cilësie pa u përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesi me licencë si dhe pa u vërtetuar nga zyra e noterit.

Vazhdimisht

19. Grupi i auditimit konstatojë, që të gjithë anëtarët e KVO-ve, kanë paraqitur të njëjtat argumente skualifikuese dhe tekste në të 3 dokumentacionet (teknike, faktike dhe financiare) në platformën elektronike të faqes së APP-së, në një kohë që mangësia është vetëm për një dokumentacion. Gjithashtu u konstatuan edhe raste, që KVO-të kanë kualifikuar OE, madje kanë shpallur edhe fitues të tenderëve, pa u plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese të miratuar nga NJP, çka në këto raste tenderët duhej të ishin anuluar dhe përsëritur nga e para, pasi ka mungesë konkurrence.

Po kështu u konstatua në të gjitha tenderët e audituar, në platformën elektronike të faqes së APP në folderin “Kuotimi”, që nuk është regjistruar çmimi përkatës, ose vlera e ofertës

ekonomike (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 102-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

KVO-të të marrin të gjitha masat për të ardhmen, që argumentimet e skualifikimeve të OE të kalojnë në folderin përkatës të dokumentit që mungon (fakt, teknik, financiar). Në respekt të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 73, KVO-të të marrin të gjitha masat, që operatorët ekonomikë, të kenë përmbushur të gjitha kriteret kualifikuese dhe që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën një ofertë e vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën dhe të filloi një procedurë të re prokurimi duke bërë më parë edhe analizën e shkaqeve të anulimit.

Gjithashtu AKQB të bashkëpunojë me APP me qëllim të ndërhyrjes në platformën elektronike për të lexuar çmimin e ofertës ekonomike në folderin “Kuotim” nga oficeri auditues.

Vazhdimisht

20. Organizimi dhe funksionimi i NJP në AKQB, nuk është kryer konformë legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, ku në shumë raste janë marrë nga njësitë vartëse të MSH, në një kohë, që duhej të funksiononte si strukturë organike më vete brenda Drejtorisë së Prokurimeve Qendrore Blerëse, pasi edhe legjislacioni nuk kërkon, që të jenë specialistë të fushës, por kërkon që të jenë me arsim të lartë dhe njëri të jetë jurist. Në AKQB është bërë rregull i përgjithshëm, që për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjeve të fondeve limit, realizohet duke caktuar grupe pune të veçanta për çdo tender. Pra, NJP nuk merren më me hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjet e fondeve limite, por vetëm me vendosjen e kërkesave kualifikuese.

Madje detyrat e NJP janë disa herë më të shumta se ato të KVO-ve e në veçanti duhet të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit, të përcaktuar qartë në rregullat e prokurimit publik.

Në LPP, Kreu II “Organizimi i prokurimit publik”, Neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 5, *AK krijon njësi prokurimi brenda strukturës së vet.*

Gjithashtu, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 57 “Njësia e prokurimit”, pika 1, duhet që AK në fillim të vitit, të krijojë njësinë e prokurimit, e cila duhet të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit, duke pasqyruar edhe detyrat dhe përgjegjësitë konkrete. Për më tepër, njësia e prokurimit, duhet të mbledhë gjithë informacionet e nevojshme për shqyrtimin e ankesave, në zbatim të siç cilësohet në Kreun X “shqyrtimi i ankesave”, neni 78 “ankesat në autoritetin kontraktor” (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 98099 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

AKQB brenda strukturës organike të Drejtorisë së Prokurimeve të ketë të përhershme edhe strukturën e Njesisë së Prokurimit si dhe ti rekomandohet APP për të bërë herë pas here edhe trajnime për prokurimet publike.

Brenda datës 31.12.2016

21. Për tenderët e blerjeve të mallrave e materialeve mjekësore llogaritjet e fondeve limite, nuk janë argumentuar në të gjitha rastet me dokumentacione përkatëse, madje cilësohet se çmimet janë marrë nga realizimet e kontratave të viteve të kaluara, në një kohë që bashkëlidhur kanë vetëm ofertën e një kompanie, pa lënë asnjë gjurmë se kjo ofertë i takon kontratës së fituesit të tenderit në vitet e kaluara. Edhe në përcaktimin e fondeve limite me argumentimin e studimit të tregut u konstatuan raste të mos dokumentimit të rregullit si të shkresave dërguar kompanive të ndryshme ashtu edhe përgjigjet e dhëna nga këto kompani, e

më e rëndësishmja është se kishte raste të ofertave të paraqitura nga kompani të ndryshme, të cilat nuk ishin të protokolluar në AKQB.

Gjithashtu edhe në procesverbalet e hartuara nga grupet e tilla të punës nuk janë lënë gjurme për kryerjet e veprimeve aritmetikore për fiksimin e vlerave të fondeve limit, si mesataren, maksimalen apo minimalen.

Ndërsa për tenderët e punëve publike në llogaritjet e fondeve limite për blerjet e pajisjeve dhe aparaturave është shtuar 20 për qind TVSH, çka bie ndesh me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër në respekt të nenit 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” dhe nenit 41 “Dokumentet e tenderit” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, nenit 10 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit etj (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 136-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

AKQB për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që çdo llogaritje e fondit limit për blerjet e mallrave e materialeve të dokumentohet me praktika të plota dokumentare zyrtare dhe duke i bashkëlidhur në dosjet përkatëse të tenderëve, pavarësisht volumit të tyre.

Gjithashtu për tenderët për punë publike që kanë edhe blerje pajisje e aparaturave të mos përfshihet në çmimin e tyre TVSH në masën prej 20 për qind.

Vazhdimisht

22. Në dy tenderë për punë publike u konstatua se fondi limit është llogaritur duke përfshirë në preventiv padrejtësisht dhe vleftën e pajisjeve dhe aparaturave, e cila ka çuar drejtpërdrejt në llogaritjen/rritjen e gabuar të fondit rezervë dhe për rrjedhojë të vlerës së objekteve (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 103-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Në kushtet që punimet në objekte janë në vazhdim, AKQB të bëjë korrigjimet në ulje të vlerave të fondeve rezervë, për mundësi përdorimi deri në kufijtë e poshtëshënuar për çdo tender, e konkretisht:

i) “Rikonstruksion në SU Shefqet Ndroqi Tiranë, për sistemimet e jashtme, kanalizimet, ndriçimi dhe ashensori në godinën e administratës, etj. Faza e III”, kufiri maksimal për përdorim të vlerës së fondit rezervë nuk duhet kaluar mbi 3,723,675 lekë nga 5,755,718 lekë të llogaritur prej OE fitues i tenderit, pra më pak 2,032,043 lekë.

ii) “Ndërtim i Godinës së Re për Qendrën e Shërbimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore” Tiranë, duhet të përdor fond rezervë më pak vlerën prej 412,701 lekë, nga fondi i llogaritur nga fituesi i tenderit në ofertën ekonomik të tij.

Brenda afatit të përfundimit të dorëzimit të dy objekteve

23. Gjatë auditimit u konstatuan raste, që kërkesat kualifikuese të veçanta si për tenderët për punë publike ashtu edhe për tenderët për blerje mallrash e materialesh mjekësore, nuk janë hartuar e miratuar konformë legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, madje u konstatuan edhe raste të mos argumentimit të tyre në procesverbalet e miratimit të dokumentacioneve të prokurimeve. Raste të tilla u vërtetuan për tenderët e prokurimeve publike në përcaktimin e numrit të punonjësve e specialistëve në përbërjet e stafeve, të numrit dhe të llojeve të makinerive e pajisjeve në dispozicion, e më konkretisht:

- janë kërkuar që të paraqitet deklarata për makineritë dhe stafin teknik, që nuk i kanë në përdorim në ndonjë tender tjetër, kërkesë kjo që diskriminon OE, që kanë lidhje vetëm me këtë AKQB, pasi me AK të tjera në shkallë vendi është e pa mundur ndonjë verifikim i tillë;

- janë vendosur kërkesa kualifikuese të veçanta të shumta e të dubluara dhe me mjaft interpretime si edhe veprime që i trajtojnë vendimet e qeverisë, si fjala vjen “një vet deklarim për të respektuar të VKM nr. 312, datë 5.5.2010 “Për sigurinë në kantier”, ose kërkuar si

kërkesë kualifikuese vizita në kantier në një kohë, që nuk është kërkesë kualifikuese, por është udhëzim përkatës për OE, madje vendosur kërkesa kualifikuese të veçanta në mjaft raste të formës së vet deklarimit të OE, e këto më të theksuara në tenderët e punëve publike, në një kohë që janë lënë mënjanë kërkesat kualifikuese të veçanta për paraqitje bilancesh kontabël, ose gjendje bankare nëpër bankat në të gjitha tenderët e audituar, që i rekomandojnë edhe rregullat e prokurimit publik;

- janë vendosur kërkesa për të vërtetuar realizimet e punëve dhe blerjeve të ngjashme për 3 vite, si duke përcaktuar 3 vitet 2012,2013 e 2014 ose duke përcaktuar vetëm 3 vitet e fundit, pra duke lënë pa përfshirë aktivitetet e vitit të fundit 2015, duke i mohuar aktivitete të ngjashme për gati 9 muaj të vitit 2015, pasi një pjesë e mirë e tenderëve të tillë janë zhvilluar gjatë muajve Tetor-Nëntor 2015;

- janë vendosur kërkesa kualifikuese të paraqitjeve të vërtetimeve të xhirove të realizuar me citim “xhiro mesatare”, në një kohë që në rregullat e prokurimit publik ka cilësim të realizimeve të xhirove vjetore;

- janë kërkuar kërkesa kualifikuese për paraqitje të certifikatave të ndryshme cilësie pa njohur më parë nga NJP se kush janë këto organe të pavarura të njohura nga sistemet kombëtare ose ndërkombëtare;

- është bërë me iniciativë të NJP ndryshim i shtojcës nr. 1 “Formulari i Ofertës”, i miratuar me rregullat e prokurimit publik, duke vendosur nr. e kompanive prodhuese, emrat e kompanive prodhuese, etj., e kjo në të gjitha tenderët e blerjeve të mallrave e materialeve mjekësore dhe blerjet e barnave;

-nuk është kërkuar kriter kualifikues i veçantë për “kapacitetin ligjor të OE”, në një kohë që në legjislacionin e prokurimit publik, neni 46 e kërkon vendosjen e këtij kriteri si tek kriteret e tjera, për të vërtetuar operatorët ekonomikë se kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës;

-në tenderët me aktivitete të ndryshme janë bërë kërkesa kualifikuese për të gjitha llojet e aktivitetit, në një kohë, që peshën kryesore e zënë aktiviteti i ndërtimit dhe kërkesat duhet bërë vetëm për veprimtarinë kryesore, për të cilën është paracaktuar, siç parashikon legjislacioni i prokurimit publik në fuqi;

-afatet e zhvillimit të tenderëve për punë publike janë disi të shkurtuara, pa pasur parasysh se është kërkuar si kërkesë kualifikuese bërja e vizitave në kantieret e ndërtimit;

-nuk është bërë argumentimi i sigurimit të ofertës, përse nuk është i zbatueshëm në tenderët konkretë të këtij AKQB;

-janë kërkuar paraqitje autorizimesh nga kompani prodhuese dhe distributor të tyre, pa kërkuar dokument vërtetues për të saktësuar ekzistencën e emrit të këtyre kompanive apo distributorëve;

-janë kërkuar shumë dokumente për të vërtetuar pasjen në dispozicion të makinerive e pajisjeve si ato në pronësi ashtu edhe për ato të marra me qira në tenderët e punëve publike e të pa nevojshme për të kontrolluar aktivitetin e tenderit përkatës, si: certifikatën e pronësisë së automjeteve, mandat pagesat për tatim taksat e paguara, në një kohë që ka kërkuar edhe certifikatën e kolaudimit të automjeteve (legjislacioni nuk lejon dhënien në asnjë mënyrë të certifikatës së kolaudimit pa bërë më parë pagimin e taksave), dokumentin e polic sigurimit të automjeteve (ky dokument plotësohet kur këto automjete janë direkt në kryerjen e volumeve të punimeve), certifikata transporti të një qarku, në një kohë që këto mjete nuk mund të punojnë më në qarqe të ndryshme të Shqipërisë, kërkuar mjete e makineri të shumta ose kërkuar rimorkiator me tonazh të lartë për transport makinerish e mjetesh, në një kohë që tenderët janë për rikonstruksione punë publike, ku në rregullat e prokurimit publik është kërkuar, që mjafton të plotësohet shtojca nr. 8 “Formular i vlerësimit për realizimin e punimeve” etj. të trajtuar hollësisht në projektraportin dhe raportin e auditimit (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 198-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

AKQB, për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që NJP kërkesat kualifikuese të veçanta ti hartojë në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit që kërkohet të prokurohet, të vendosen kritere të nevojshme (jo të shumta e të dubluara), pa lënë shteg për interpretime dhe të jenë shumë të kuptueshme e të karakterit për të ndihmuar biznesin e vogël dhe të mesëm. Për kërkesat kualifikuese të veçanta të miratuara detyrimisht të kërkohen shoqërimet me dokumentet vërtetues (jo jashtë aktivitetit të tenderit) siç është përcaktuar në shtojcën nr. 9 si dhe të përcaktohen organet përkatëse që lëshon dokumente të tilla vërtetuese.

Vazhdimisht

24. Autoriteti kontraktor ka lidhur kontratë me fituesin BOE “I. & C..” për tenderin me objekt *“Implementimi i nënshkrimit elektronik për qytetarët dhe profesionistët për përdorimin e shërbimeve të shëndetësisë elektronike”*. Në nenin nr. 25 të kontratës “Likuidimi i Dëmeve për dorëzimin e vonuar”, për llogaritjen e tarifave janë vendosur të tre klauzolat, që ka të përcaktuar në DST, si 4/1000; 2/1000 dhe 1/1000 sipas afateve respektivisht jo më shumë se 6 muaj, jo më shumë se 12 muaj dhe mbi 12 muaj (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 175-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

AK, në kontratat që do të lidh me operatorët ekonomikë, të shënojë vetëm njërit kusht të penaltetit dhe saktësisht atë që është përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe në rastin konkret afati i zbatimit të kësaj kontrate është mbi 6 muaj, për rrjedhojë kushti i penaltetit duhet të ishte fiksuar vetëm 2/1000 e vlerës së mbetur pa u realizuar nga çmimi total i kontratës, e jo të 3 klauzolat e cilësuar në DST.

Vazhdimisht

25. Në të gjitha tenderët e audituar, plotësimi dhe administrimi i dosjeve të tenderëve nuk paraqiten në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar nga marrësi dhe dorëzuesi, nuk janë plotësuar sipas ligjit për arkivat, ka edhe mungesë të dokumentacioneve shoqëruese, si për rastet e vërtetimit të llogaritjeve të fondeve limit, ashtu edhe të dokumenteve që paraqesin më vonë në observacion KVO-të, me pretendimin se janë dokumente të shumta, etj. të kësaj natyre.

Në mos administrimin e rregullt të dosjeve të tilla ka influencuar edhe puna e pakujdesshme e NJP, pasi janë të angazhuar përkohësisht nga jashtë institucionit të MSH, duke qenë nëpunës të njëjësive vartëse të kësaj ministrie.

Mos kryerjet e veprimeve të tilla bie ndesh më LPP, me ndryshimet, Kreu II “Organizimi i prokurimit publik”, neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 3, që cilëson: *“Autoriteti kontraktor administron për të gjitha procesverbalet për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër ... ”* (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 98-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

AKQB të marrë të gjitha masat sa më parë për të sistemuar, administruar dhe dorëzuar këto dosje dhe për të ardhmen në respektim të ligjit “Për arkivat”.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

26. Nisur nga numri i lartë i institucioneve të varësisë që ka aktualisht Ministria e Shëndetësisë 89 gjithsej, shpenzimi/përdorimi në shuma të mëdha i fondeve, faktit që në bazë të planit strategjik të miratuar nga MSH, rreth 31 institucione të varësisë janë vlerësuar me risk të lartë, të cilët në bazë të manualit dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 2.3.2, duhet të auditohen çdo vit, rezulton se numri i audituesve të Drejtorisë të

Auditit të Brendshëm, është i pamjaftueshëm, nuk mund të përballojë realizimin e detyrave si më lart.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, për mungesë audituesish, ka parashikuar auditimin e këtyre subjekteve jo një herë në vit, por një herë në dy vjet (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 180-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, të vendosë një raport sa më të drejtë midis misionit/ngarkesës, detyrave funksionale të kërkuara/parashikuara, me nevojat reale për auditimin e institucioneve të varësisë dhe mundësive faktike që ka struktura aktuale e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Duke qenë se objektet e auditimit janë të së njëjtës natyre dhe të krahasueshëm në përgjithësi për problemet e mundshme, treguesit kryesorë ekonomikë e financiarë, përfundimet/rekomandimet e auditimeve të subjekteve të veçanta, mund ti bëhen të njohura që ti kenë në konsideratë në aktivitetin e tyre, subjekteve të tjera të varësisë me qëllim parandalimin e parregullsive eventuale dhe përmirësimin e nivelit administrativ dhe ekonomik.

Në vazhdimësi.

27. Nga verifikimi i dosjeve të auditimit të brendshëm, u konstatua se pas evadimit të materialeve të auditimit apo, të mbarimit të shërbimit operativ, dosjet e auditimit janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara, në kundërshtim me nenin 15, 30 etj, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” etj.

Gjithashtu, nga auditimi i dosjeve u evidentuan mangësi dokumentesh të ndryshme në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në manualin e auditimit të brendshëm dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik” (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 180-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të marrë masat e nevojshme, që me evadimin e materialeve të auditimit, ose të mbarimit të shërbimit operativ, dosjet e auditimit të plotësohen me dokumentacionin përkatës, të inventarizohen dhe të arkivohen në përputhje me dispozitat ligjore për arkivat.

Në vazhdimësi.

28. Në rregullore e Ministrisë së Shëndetësisë gjendet “Rregullore...” ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e çdo drejtorie, sektori dhe punonjësi, si dhe mënyrat e komunikimit, të cilat si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore dhe angazhimeve të reja ligjore që drejtoritë duhet të përmbushin në kuadër të funksionimit të tyre, kanë nevojë për rishikim të vazhdueshëm.

Për vitin 2014 ashtu si dhe për vitin 2015, regjistri i riskut është hartuar për të gjitha programet buxhetore dhe aktualisht institucioni është në fazën e përgatitjes së një regjistri përmbledhës, por grupi i auditimit konstatoi se nuk janë marrë masa për parandalimin e riskut, komponent ky i cili shkakton mos arritjen e objektivit primar duke minimizuar mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar me impakt negativ (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 180-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë të marrë masat e nevojshme me qëllim azhurnimin në kohë të ndryshimeve të shpeshta të rregulloreve, pasi në të kundërt, paraqesin risk potencial për moszbatimin e përgjegjësisë, duke mos lejuar punonjësit të asimilojnë rregullat ekzistuese. Nëpunësi autorizues të marrë masa për regjistrimin, raportimin dhe hartimin e një plan

veprimi mbi masat të cilat institucioni duhet të ndërmarrë për parandalimin e parregullsive apo risqeve të parashikuara.

Vazhdimisht.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Dëmi ekonomik i shkaktuar është **39,916,542 lekë** gjithsej, nga i cili:

B.I. *I arkëtueshëm 33,672,484 lekë*, për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. Operatorit ekonomik “A.”, vlerën **26,445,396 lekë**, për shkak se në tenderin me objekt *“Hartimi i Projekt – Preventiv zbatimi për ndërtimin e Spitalit të Ri Rajoni, Fier”*:

- KVO në vlerësimin e ofertës fituese nuk ka bërë verifikimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar në dokumentat e tenderit e konkretisht, për pagat e punës të deklaruara në Degën e Tatim Taksave sipas formularit “E Sig-25G” sipas kategorisë së punës dhe pagesat ditore të paraqitura në ofertën ekonomike, për hartimin e projekt-preventivit.

Nga krahasimi shpenzimeve për pagat, u konstatua se pagat ditore të zërit “Arkitektura” të llogaritura në ofertë, janë 5 deri 9 herë më të larta se sa pagat e raportuara zyrtarisht sipas formularit “E-SIG 25” të deklaruar në Degën e Tatim Taksave, me pasojë rritjen artificiale të ofertës ekonomike me vlerë **22,373,440 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik dhe evazion fiskal në të ardhurat tatimore.

- Në procesin e vlerësimit të ofertave dhe shpalljes së ofertës fituese, OE fitues “A.” ka shtuar në ofertë zërin “Fitim”, me vlerë prej **8,280,000 lekë**, në kundërshtim me dokumentet standard të tenderit të miratuar nga APP dhe vetë dokumentet e tenderit të hartuara nga Autoriteti Kontraktor, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë në vlerën **4,071,956 lekë**, pas llogaritjeve/ndryshimeve të kryera nga grupi i auditimit në shpenzimet direkt (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. OE “B.. E.” sh.p.k. vlerën 148,860 lekë, nga e cila:

- Vlerën **80,156 lekë**, për shkak se në zbatimin e kontratës nr. 4079/1, datë 12.10.2015 për blerje fotokopje, nuk janë zbatuar afatet e lëvrimit të mallit. Kontrata është lidhur me subjektin më datë 12.10.2015, me afat 45 ditë nga lidhja e saj, pra data 27.11.2015, ndërsa më datë 22.12.2015 është likuiduar vlera **1,001,954 lekë**. Fatura e subjektit është lëshuar më datën 17.12.2015, po kështu dhe procesverbali i marrjes në dorëzim dhe fletëhyrja e magazinës. Nga sa më sipër rezulton se lëvrimi i mallit është bërë me 20 ditë vonesë, për të cilën OE duhet të paguante penalitet në shumën **80,156 lekë** (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 11-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Vlerën **68,704 lekë**, pasi në zbatimin e kontratës për blerje dhe vendosje të kasave fiskale për institucionet e varësisë, në shumën **2,530,440 lekë**, nuk janë zbatuar afatet e lëvrimit të mallit. Bashkëlidhur praktikës nuk ka fletëhyrje të mallit në magazinat e institucioneve të përcaktuara në planin e shpërndarjes. Për lëvrimin me vonesë i mallit, referuar nenit 11 të kontratës “Sanksionet”, OE duhet t’i ishin llogaritur dhe mbajtur penalitet në vlerën **68,704 lekë** (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. OE “N.. M.. P.”, vlerën **4,952,198 lekë**, për shkak se në tenderin me objekt *“Rikonstruksion në S. U. Shefqet Ndroqi Tiranë, për sistemimet e jashtme, kanalizimet, ndriçimi dhe ashensori në godinën e administratës, etj. Faza e III”*:

- Ka përfituar vlerën 1,218,998 lekë, e cila përfaqëson rritjen e padrejtë të fondit limit, për shkak të diferencës midis çmimit prej 1441 lekë m³ të vendosur në preventiv në faqen nr. 1, pika I, në pikën nr. rendor 3, analiza 164/1a, ndërkohë që në manualin e çmimeve të ndërtimit çmimi i këtij zëri punimesh është 614 lekë m³.

- Ka përfituar vlerën 3,733,200 lekë, e cila përfaqëson TVSH e llogaritur mbi vlerën e pajisjeve e aparaturave, si kondicionerë, pajisjet elektrike, pompave dhe ashensorit të montuar në objekt dhe përfituar padrejtësisht në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, në të cilën është përcaktuar se ... në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat dhe UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 103-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. OE “E..” sh.p.k. vlerën 1,377,180 lekë e cila përfaqëson TVSH e llogaritur mbi vlerën e pajisjeve e aparaturave, si kondicionerë, pajisjet elektrike, pompave dhe ashensorit të montuar në tenderin me objekt “Ndërtim i Godinës së Re për Qendrën e Shërbimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore” Tiranë objekt dhe përfituar padrejtësisht në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, në të cilën është përcaktuar se ... në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat dhe UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 120-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Subjektit “T..” sh.p.k. vlerën 748,850 lekë, e cila përfaqëson diferencën e çmimit midis manualit të çmimeve që duhet të ishte vendosur shoqëria “T..” sh.p.k. e cila ka hartuar projektpreventivin e “Rikonstruksioni i godinës së maternitetit” për Spitalin Rajonal Gjirokastër, dhe çmimit të vendosur në fakt në zërin e punimeve me nr. Analize 2.198 “Hidroizolim” 2 duar guajn alumini me çmimin për njësi 2,790 lekë/m².

Nga verifikimi në manualin e çmimeve të miratuar me VKM nr. 568, datë 26.6.2013 në bazë të cilit është hartuar preventivi, këtij zëri punimi i takon numri i analizës 2.197 me çmimin për njësi 1,909 lekë/m², ose me diferencë për njësi 881 lekë/m² (2,790 – 1,909), ose me vlerë të rritur në preventiv padrejtësisht 748,850 lekë (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

B.II. Dëm ekonomik, pa mundësi arkëtimi në vlerën 6,244,058 lekë.

Ky dëm është evidentuar në procedurën e tenderit me objekt “B3- Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut për nevoja spitalore” loti 12 me fond limit 55,127,233 lekë, i zhvilluar në vitin 2016.

Kjo procedurë është mbyllur nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).

Pavarësisht sa më sipër, kjo procedurë tenderi u auditua dhe në përfundim të saj ndër të tjera rezultoi se:

AK ka kualifikuar dy OE, nga të cilët OE “B.. A..” sh.p.k., me ofertë 59,898,804 lekë vend të parë dhe OE “M..” sh.p.k, me ofertë 66,141,662 lekë.

KVO në procesverbalet përkatës ka argumentuar hollësisht shkaqet/arsyet e këtij vlerësimi.

Për këtë përfundim, OE “M..” sh.p.k. ka bërë ankesë pranë AK.

Zyrtari për shqyrtimin e ankesës i caktuar nga AK, ka refuzuar ankesën e OE “M..” sh.p.k. duke argumentuar hollësisht shkaqet/arsyet e këtij refuzimi.

KVO dhe zyrtari për shqyrtimin e ankesës të M SH, në pozicionin e *specialistëve të fushës*, (në zbatim të nenit 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”), i kanë kthyer përgjigje të drejtpërdrejtë negative OE “M..” sh.p.k, duke argumentuar teknikisht/profesionalisht se medikamenti i ofruar nga OE “B.. A..” sh.p.k., i plotëson tërësisht kriteret e përcaktuara në DST nga autoriteti kontraktor (është i njëjtë me medikamentin që ka ofruar OE “B..” sh.p.k.).

Për këtë vlerësim, OE “M..” sh.p.k. ka bërë ankesë pranë KPP.

KPP i përbërë nga G.. K.. kryetar, S.. K.. zv/kryetar, J.. H., L.. G.. dhe H.. B.. anëtarë, me vendim nr. 302/2016 ka pranuar ankesën e OE “M..” sh.p.k, sipas së cilës, medikamenti i sjellë/ofruar në tender nga OE “B..” sh.p.k., nuk është i njëjtë, por është i ndryshëm nga ai i kërkuar/përcaktuar në DST nga AK.

Në tërësi, në arsyetimet e veta KPP, në tejkallim të mundësive/kapaciteteve profesionale (*pa si në përbërje nuk ka specialistë të fushës*), duke hedhur poshtë mendimin e specialistëve të fushës, është përpjekur të argumentojë/kombinojë padrejtësisht, pa lidhje, jashtë kontekstit, nene të ndryshme të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin 8 farmaceutik” për produktet IMMUNATE 500 I.E. FV III/375 I.E. VËF me princip akti :Faktori VIII i koagulimit human 500 IU dhe Faktor Von Willebrand human 375 IU si edhe për produktin IMMUNATE 250 I.E. FV III/190 I.E. VËF me princip aktiv Faktori VIII i koagulimit human 250 IU dhe Faktor Von Willebrand human 190 IU, *duke u thelluar në veçanti efektet terapeutike të tyre*, ndryshimet terapeutike midis tyre etj.

Rrjedhje direkte e këtij vendimi të KPP është skualifikimi i padrejtë i OE “B..” sh.p.k. me ofertë 59,898,804 lekë i klasifikuar në vend të parë nga AK dhe kualifikimi në vend të parë (për më tej shpallja fitues) i OE “M..” sh.p.k, me ofertë 66,141,662 lekë, ose 6,242,858 lekë më tepër se sa oferta e OE “B..” sh.p.k, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KPP.

Ajo që vlen të evidentohet në vendimin e KPP është “Mendimi Kundër” i anëtares se KPP, J. H.

Në tërësi në arsyetimin e vet, ajo mbështet vlerësimet/përfundimet e KVO dhe zyrtarit të shqyrtimit të ankesës të M SH.

Në argumentet e saj, ndër të tjera ajo ka theksuar dy elementë që padrejtësisht, nuk janë konsideruar nga KPP:

- Faktin që autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë, nuk shfaqet vetëm në cilësinë e një autoriteti kontraktor në kuptim të ligjit për prokurimin publik, por edhe njëherazi organi më i specializuar në rang vendi për të ofruar një ekspertizë mbi përbërësit/efektet e produkteve farmaceutike.

- Ekspertiza e posaçme nga ekspertë të fushës në zbatim të nenit 23, pika 3 germa “b” të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” ... që duhet të kishte kërkuar KPP, për një informacion/vlerësim nga ekspertë të fushës mbi kërkimet se në rast se produkti i ofruar nga

ana e operatorit tjetër ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, është i njëjtë me produktin e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe nëse faktori Von Willebrand, i cili shfaqet si princip aktiv në produktin e ofruar nga operatori ekonomik “B.. A..” sh.p.k. ka ndikim terapeutik të ndryshëm në medikamentin në tërësi, nga ai i kërkuar nga autoriteti kontraktor (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 187-195 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R